



Prishtinë, 29 dhjetor 2010

Kodi i ZRRE-së: V_330_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna me Nenin 14 pika 2.6 dhe Nenin 43, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.03/L-185;
- Dispozitat e Nenit 17 të Ligjit për Energjinë Nr. 03/L-184; dhe
- Kërkesën e Ngrohtores së Qytetit (NQ) Termokos SH.A për shqyrtimin e tarifave të ngrohjes qendrore, të datës 20 tetor 2010,

në seancën e mbajtur me datë 29 dhjetor 2010, nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHEN** tarifat e ngrohjes qendrore për Ngrohtoren e Qytetit (NQ) Termokos SH.A. për sezonin e ngrohjes 2010/2011, të cilat do të zbatohen prej datës 1 janar 2011, siç janë paraqitur në tabelat "A" dhe "B" .

Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 20 tetor 2010 nga Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Termokos SH. A ka pranuar kërkesën për shqyrtimin e tarifave të ngrohjes qendrore.
 2. Për vendosjen e tarifave të ngrohjes qendrore, ZRRE ka marr parasysh:
 - Të Ardhurat e Lejuara siç janë përcaktuar në dokumentin: Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara për NQ Termokos SH. A. – Sezoni i Ngruhjes 2010/2011; dhe
 - Llogaritjen e detajuar të tarifave siç paraqitet në dokumentin: Përcaktimi i Tarifave për NQ Termokos SH. A. – Sezoni i Ngruhjes 2010/2011.
 3. Duke marr parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e të gjitha shkresave dhe dokumenteve relevante, Bordi ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II.** Struktura e tarifave të Ngrohtores së Qytetit Termokos SH. A për sezonin e ngrohjes 2010/2011 janë si në tabelën e mëposhtme:

**TARIFAT PËR NGROHTOREN E QYTETIT TERMOKOS SH.A.
PËR SEZONIN E NGROHJES 2010/2011**

Tabela A. TARIFA PËR KONSUMATORËT PA MATJE

| NGROHTORJA E QYTETIT TERMOKOS SH.A. | | |
|---|----------------------------------|---|
| Komponentet e Tarifave | Konsumatorët shtëpiakë | Konsumatorët Komerเชียลë e Institucionalë |
| Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse) | 0.06 [€/m ² për muaj] | 0.08 [€/m ² për muaj] |
| Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile) | 0.78 [€/m ² për muaj] | 0.92 [€/m ² për muaj] |

Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT ME MATJE

| NGROHTORJA E QYTETIT TERMOKOS SH.A. | |
|---|----------------------|
| Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse) | 0.70 [€/kW për muaj] |
| Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile) | 45.50 [€/MWh] |

- III. NQ Termokos SH. A duhet ta publikoj këtë vendim në së paku një prej gazetave ditore me qarkullim të gjerë në Kosovë, brenda pesë (5) ditëve të punës, pas marrjes së vendimit dhe publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së.
- IV. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejt, që të auditojë regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Termokos SH.A. për të verifikuar realizimin e të dhënave të paraqitura nga NQ Termokos SH.A. në aplikacionin për tarifa.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar